



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 233/3 Prot.

Tiranë, më 01. 06. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 132, Datë 01. 06. 2018**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 22, datë 08.02.2018, e Shoqatës Maqedonase “*Ilinden*”, kundër përfaqësuesit të komunitetit Vlleh në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, K. G., në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të etnisë*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

Shoqata Maqedonase “*Ilinden*”, Tiranë dhe Dega e saj Gollobordë, sqarojnë se më datë 06.02.2018, nga ana e përfaqësuesit të komunitetit Vlleh në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, gjatë një shkrimi në profilin e tij të Facebook-ut, Republika Maqedonase është emërtuar FYROM. Sipas Shoqatës “*Ilinden*”, deklarata e bërë nga ana e K. G., është e papërshtatshme dhe fyese ndaj minoritetin maqedonas në Shqipëri.

Në përfundim, Shoqata Maqedonase “*Ilinden*”, ka kërkuar që K. G. të kërkojë falje publike minoritetit kombëtar maqedonas, lidhur me shkrimin e cituar në faqen e tij të facebook-ut.

*Etnia*, është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

a) .....

b) *legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.*

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitimit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të gërmës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi.

*“Interesi i ligjshëm”* është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimitimin e saj në kryerjen e ankesës.

Nëse do t’i referohemi Vendimit nr. 2473, datë 06.02.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilit Shoqata “ILINDEN” është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është: *“Mbrojtja e identitetit etnik, kulturor dhe fetar të minoritetit maqedonas në Shqipëri”*.

Mbështetur në shkrimin në profilin e tij të Facebook-ut, Republika Maqedonase është emërtuar FYROM, rezulton se ai i referohet shtetit të Maqedonisë dhe jo minoritetit maqedonas në Shqipëri.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhënie me organet shtetërore shqiptare, por mbështetur në objektin e veprimtarisë së Shoqatës “ILINDEN”, të përcaktuar saktësisht në vendimin nr. 2473, datë 06.02.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioneri gjykon se Shoqata në fjalë, përfaqësuar nga G. GJ. nuk legjitimohet dhe nuk ka asnjë tagër, për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së identitetit etnik e më gjerë, të popullit maqedonas, në shtetin fqinj.

**Pavërsisht konstatimit të sipërcituar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në respektim të të drejtave të minoriteteve kombëtare, si dhe të bashkëjetesës dhe mirëkuptimit të shqiptarëve me pakicat, vijoi shqyrtimin e ankesës në mënyrë që t’i jepej një zgjidhje lidhur me emërtimin dhe termin zyrtar, me të cilin njihet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar shteti Maqedonas.**

2. Përsa më lart, me anë të shkresës nr. 233 prot., datë 05.04.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, iu drejtua Ministrisë së Punëve të Jashtme, në të cilën kërkoi informacion mbi pretendimet e palës ankuese, lidhur me emërtimin dhe termin zyrtar, me të cilin njohet në nivel ndërkombëtar shteti Maqedonas.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, nëpërmjet shkresës<sup>1</sup> nr. 7270 prot., datë 30.04.2018, informoi KMD-në se: *“...Republika e Shqipërisë, në marrëdhëniet dypalëshe e njeh me emërtimin “Republika e Maqedonisë”, ndërsa në marrëdhëniet shumëpalëshe në organizatat ndërkombëtare e njeh me emërtimin “FYROM”*.

---

<sup>1</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 233/2 prot., datë 03.04.2018

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

### **Mbështetur në provat e administruara nga palët, rezultoi se:**

Shteti shqiptar është angazhuar për të respektuar të drejtat e minoriteteve kombëtare, duke formalizuar vullnetin e vet përmes nënshkrimit më 29.06.1995 dhe ratifikimit më 28.9.1999 të Konventës Kuadër “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, e cila hyri në fuqi më 11.01.2000. Për më tepër legjislacioni shqiptar përmban bazat ligjore për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 3 të saj parashikon se “*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë*”.

Në mbrojtje të parimit të barazisë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 18 të saj “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligjje e arsyeshme dhe objektive”. Në nenin 20 të Kushtetutës parshikohet shprehimisht se “1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre.”.

Në nenin 20 të Kushtetutës parshikohet shprehimisht se: “1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. 2. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t’i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre”.

Bazuar në informacionin e marrë në faqen zyrtare të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, komuniteti Maqedonas i cili banon në zonën e Prespës, në territorin e Republikës së Shqipërisë, njihet zyrtarisht si Minoritet Maqedonas, i njohur nga shteti shqiptar me të drejtat për përdorimin e lirë të gjuhës amtare maqedonase, të ruajtjes e zhvillimit të traditave kulturore, zakoneve etj.

Mbështetur në shkresën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Republika e Shqipërisë shtetin e Maqedonisë, në marrëdhëniet dypalëshe e njeh me emërtimin “Republika e Maqedonisë”, ndërsa në marrëdhëniet shumëpalëshe në organizatat ndërkombëtare e njeh me emërtimin “FYROM”.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri, vlerëson se shkrimi i përcjellë nga K. G. në faqen e facebook-ut, nuk ka patur si qëllim që të nxisë qëndrime denigruese ndaj komunitetit maqedonas,

por ka patur si qëllim publikimin e faktit që Radio Televizioni Shqiptar, ka bërë pjesë të punës, realizimin programeve televizive në gjuhën e minoriteteve në Shqipëri. Në këtë rast liria e shprehjes nuk ka tejkalar kufijtë e vendosur, që në rast kapërcimi do të justifikonin ndërhyrjen e shtetit për kufizimin e saj.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1<sup>2</sup>, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërcituara, Komisioneri gjykon se, pretendimet e Shoqatës Maqedonase “*Ilinden*”, se etnia është bërë shkak për trajtimin në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë, nuk mbështetet në asnjë nga provat dhe faktet e administruara nga Komisioneri gjatë procedurave hetimore.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, Shoqatës Maqedonase “*Ilinden*”, për shkak etnisë, nga ana e përfaqësuesit të komunitetit Vlleh në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, K. G.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

---

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Etnia)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>2</sup> Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.